



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

**Nr. 500 Vendimi**  
**Tiranë, më 13.01.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Alma Faskaj</b>	<b>Relator</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 05.01.2022, mori në shqyrtim në seancë në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vijueshmërinë e procesit të subjektit të rivlerësimit Tom Dedaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Tom Dedaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe pasi analizoi çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

- 1.** Z. Tom Dedaj ka qenë subjekt rivlerësimi, për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 , “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ( në vijim ligji nr. 84/2016), i cili i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për herë të parë *ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit*. Ky vendim është marrë pas diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e Komisionit të datës 7.3.2018, ku u vendos që në rregulloren e shortit të Komisionit të shtohet një pikë, e cila parashikohet se: *“Në rast të dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, të cilët nuk janë shortuar ende në përputhje me këtë rregullore, shqyrtimi i kërkesës do të bëhet nga një trup gjykues i përzgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare”*. Në vijim me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, vendimin nr. \*\*\*, datë 13.2.2020, nga Komisioni janë ngritur edhe dy trupa gjykues të tjerë të gatshëm.
- 3.** Me vendim nr. \*\*\*, datë 11.2.2021, “Për ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit”, u vendos ngritja e trupit gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Suela Zhegu dhe Firdes Shuli, i cili do të ushtrojë këtë detyrë për periudhën njëvjeçare (8.3.2021 – 8.3.2022). Trupi gjykues i gatshëm ka caktuar me mirëkuptim relatore komisioneren Alma Faskaj, si dhe ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit nga anëtarët e tij.
- 4.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendim nr. \*\*\*, datë 19.7.2017, ka miratuar “Rregullore për veprimtarinë e Komisionit”.
- 5.** Në vijim, me vendim nr. \*\*\*, datë 14.12.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi që në tekstin e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” , të shtohen në pikën 11, reshti i tretë, pas togfjalëshit “*kanë mbushur moshën për pension*” togfjalëshat “ *ndërruar jetë/janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë*”.
- 6.** Menjëherë pas ngritjes së trupës u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga institucionet ndihmëse. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

7. Komisioni, përgjatë hetimit konstatoi se në ngarkim të z. Tom Dedaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nisur nga emisioni “Fiks fare” i televizionit *Top-Channel*, ka regjistruar procedimin penal nr. 235, datë 24.10.2016, për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

8. Me urdhrin nr.\*\*\*datë 31.10.2016, është vendosur pezullimi nga ushtrimi i detyrës për prokurorin Tom Dedaj, deri në përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 24.10.2016.

9. Në datën 24.4.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pas përfundimit të hetimeve ka dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, procedimin penal me nr.\*\*\*2016, në ngarkim të të pandehurit Tom Dedaj.

10. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2018, ka vendosur: *Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Dedaj për kryerjen e veprës penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ ç i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.*

Gjithashtu, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në aplikim të nenit 30, pika 1, nenit 35, nenit 44, pika 2, e Kodit Penal ka dhënë si dënim plotësues heqjen e së drejtës për të pandehurin Tom Dedaj për të ushtruar funksione publike për 5 (pesë) vjet. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien në provë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

11. Pasa të të pandehurit Tom Dedaj kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 26.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, ka ndryshuar akuzën për të pandehurin dhe ka vendosur:

*- Deklarimin fajtor të të pandehurit Tom Dedaj për kryerjen e veprës penale “moskallëzim të krimi”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.*

- Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin Tom Dedaj dhe vënien në provë për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë ndonjë vepër tjetër penale. [...]

- Në bazë të nenit 35/2, 30/1 dhe 44/2 të Kodit Penal, ndaj të pandehurit Tom Dedaj jepet një dënim plotësues “Heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një kohë prej një viti” [...].

**12.** Referuar vendimeve të mësipërme dhe urdhrimit të prokurorit, datë 24.12.2018, “Për ekzekutimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, për të dënuarin Tom Dedaj”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 22, datë 28.1.2019, “Për shkarkimin nga detyra të prokurorit” vendosi: *Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.*

**13.** Duke mos qenë dakord me këtë vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Tom Dedaj e ka bërë çështjen konflikt gjyqësor dhe i është drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë me kërkesëpadinë me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj; 2. kthimin në detyrën e mëparshme të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër; Faqja 4 nga 12 3. dhënien e pagës nga data 28.1.2019 dhe në vazhdim; 4. dhënien e një shpërblimi të drejtë në shumën 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë; 5. konstatimin e diskriminimit ndaj paditësit Tom Dedaj; 6. anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket certifikimit, dhënies së mandatit si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të anëtarëve: G. I., T. B., B. Sh., A. D., A. S., B. C., G. O. dhe N. S.; 7. anulimin pjesërisht të vendimit të Mbledhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë të datës 19.12.2018, për sa i përket konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; 8. pezullimin e vazhdimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e procesit gjyqësor; 9. pezullimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri në përfundimin e gjykimit të kësaj çështje – me palë të paditura, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë”.*

**14.** Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin e datës 17.12.2019, bazuar në pikën 3, të nenit 13, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, që parashikon se: “*Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar , ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 22.10.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ”.*

Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.10.2019, ka vendosur:

- *Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e pikave 1, 2, 3 dhe 9 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

*- Shpalljen e moskompetencës funksionale të Gjykatës së Apelit Administrativ për shqyrtimin e pikave 4, 5, 6, 7 dhe 8 të objektit të kërkesëpadisë së paditësit Tom Dedaj dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

**15.** Sa më sipër, çështja është përcjellë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, i cili është vënë në lëvizje nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë. Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit është regjistruar çështja nr. 1/2019, që i përket juridiksionit disiplinor, me kërkes Tom Dedaj dhe subjekte të interesuara Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.

**16.** Komisioni administroi nga faqja zyrtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit vendimin nr.1/2019 JD, datë 20.7.2020. Në përmbajtje të vendimit nr. 1/2019 JD, datë 20.7.2020, Komisioni konstaton se:

**16.1** Kolegji i shqyrtimit paraprak pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi analizoi bazën ligjore të zbatueshme lidhur me gjykimin e çështjes nr. 1/2019, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit referuar edhe nga parashikimi i pikës 1, të nenit 192, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, që përcakton: *“Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese, arrihet në përfundimin se Kolegji i Posaçëm i Apelit është gjykata kompetente që shqyrton ankimet ndaj vendimeve të këshillave për marrjen e masave disiplinore ndaj magjistratëve”.*

**16.2** Kolegji i shqyrtimit paraprak, pasi analizoi aktet e dosjes gjyqësore të çështjes nr. 1/2019, datë 19.12.2019, që i përket Juridiksionit Disiplinor, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 22, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, si një akt administrativ individual që vendos masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, në referim të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 3, të nenit 31, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, ku parashikohet: *“[...] Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e Kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve”*, me vendimin nr. 1/1, datë 3.2.2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak mbledhjes së gjyqtarëve. Mbledhja e gjyqtarëve, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur, në bazë të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, në mbledhjen e datës 7.2.2020 vendosi: *“Kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike të kërkesës së kërkuarit Tom Dedaj”.*

**16.3** Në zbatim të nenit 134, pika 1, germa “i”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon se: *Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: [...] individëve*, dhe nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike Kolegji i Posaçëm i Apelit, pasi verifikoi legjitimitetin e kërkuarit Tom Dedaj, vullnetin e tij lidhur me ankimin kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra të paraqitur përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe paraqitja

e këtij vullneti në formën e duhur ligjore, në kuadër të informimit dhe transparencës të veprimtarisë së Kolegjit, nga momenti i regjistrimit të kësaj çështjeje të juridiksionit disiplinor, ka publikuar në faqen zyrtare në internet të Kolegjit të dhënat e çështjes, palët e interesuara, përbërja e kolegjit të shqyrtimit paraprak të kërkesës, data e zhvillimit të seancës publike, statusi i procedurës së çështjes etj.

**16.4** Gjithashtu, referuar përmbajtës së vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të publikuar rezulton se Kolegji, me shkresën, datë 7.2.2020, ka njoftuar kërkuuesin Tom Dedaj se do të gjykojë në datën 24.3.2020, ora 10:00, në seancë plenare publike, kërkesën kundër vendimit nr. 22, datë 28.1.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ka vendosur: 1. Shkarkimin nga detyra të prokurorit Tom Dedaj, bazuar në vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*, datë 6.11.2018, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë [...]. Me vendimin nr. 06, datë 11.3.2020, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e virusit COVID-19 në vend dhe në kuadër të masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar prej tij, ka vendosur të shtyjë deri në një njoftim të dytë seancën gjyqësore publike që i përket çështjes (JD) nr. 1/2019, me kërkuues Tom Dedaj, caktuar për t'u zhvilluar ditën e martë, datë 24.3.2020, ora 10:00. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën, datë 19.6.2020, njoftoi kërkuuesin për zhvillimin e seancës gjyqësore publike më datë 20.7.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 20.7.2020, ora 10:00. Kolegji nga verifikimi i paraqitjes së pjesëmarrësve dhe përfaqësuesve të tyre, rezultoi se kërkuesi Tom Dedaj nuk u paraqit në seancë, edhe pse kishte marrë njoftimin për zhvillimin e saj që në datën 22.6.2020. Subjektet e interesuara, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, gjatë seancës gjyqësore publike, kanë kërkuar zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuetit Tom Dedaj. Kolegji i Posaçëm i Apelimit konstaton se kërkuesi Tom Dedaj, edhe pse ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes në Kolegj, që prej kalimit të saj për kompetencë nga Gjykata e Apelit Administrativ, nuk ka paraqitur kërkesën apo parashtrime me shkrim në lidhje me objektin e gjykimit dhe pretendimet e tij. Kërkuesi është njoftuar dhe ka marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e seancës plenare publike, por nuk është paraqitur dhe nuk ka depozituar kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshem. Kolegji, në vijim të situatës faktike si më sipër, se kërkuesi, me mosparaqitjen, ka demonstruar mungesën e vullnetit të tij për t'ia nënshtruar gjykimin e kësaj çështjeje juridiksionit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pasojë ky vlerësim i parë lidhur edhe me mungesën e një akti formal drejtuar Kolegjit, i shpjeguar më lart se ka ndodhur për shkaqe të ndërvarura nga zgjedhjet procedurale të subjektit dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, e çon Kolegjin në përfundimin se situata faktike e përshkruar duhet të trajtohet si një heqje dorë nga kërkesa, në kuptim të parashikimit në nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000.

Duke vlerësuar çështjen në këtë mënyrë, në zbatim të nenit 31/b, pika 1 e ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se: *Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes*, Kolegji ka arritur në përfundimin se gjykimi i kësaj çështjeje pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit duhet të pushohet.

**16.5** Për këto arsye, Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/b, pika 1, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin

dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, ka vendosur: *Pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1, datë 19.12.2019, të juridiksionit disiplinor, që i përket ankimit të z. Tom Dedaj, kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.*

17. Gjithashtu, përgjatë hetimit rezultoi se z. Tom Dedaj ka paraqitur në datën 9.7.2021 kërkesën me objekt “rifillimin e Gjykimit të çështjes”, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Komisioni administroi nga faqja zyrtare e Kolegjit të Posaçëm të Apelit vendimin nr. 2, datë 4.10.2021, nr. regjistrimi 6/2021 JD, me kërkuese z. Tom Dedaj me objekt “Rifillimin e gjykimit të çështjes”. Referuar përmbajtës së vendimit sa më sipër, Komisioni konstatoi se Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh”, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur: *mos kalimin e çështjes në seancë plenare.*

18. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 2/b të nenit 148, përcakton se prokurori shkarkohet nga detyra, kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë.

#### **ARSYET E NDËPRERJES SË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR**

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin 84/2016.

20. Trupi gjykues konstaton se z. Tom Dedaj ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke qenë subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*.

21. Në germen “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni”*.

22. Me vendim nr. 22, datë 28.1.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Tom Dedaj është shkarkuar nga detyra mbështetur në nenin 148/d, pika 2, germa “b”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, pas dënimit të tij me një vendim penal të formës së prerë.

23. Z. Tom Dedaj i ka mbaruar statusi i magjistratit, pasi shkarkimi nga funksioni përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të gremës “ç”, të nenit 64, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

24. Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, ka parashikuar pamundësinë në objekt apo qëllim, ku sipas kësaj dispozite, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

25. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pikën 148/d, pika 2, germa “b”, përcakton se: *“Prokurori shkarkohet nga detyra, kur është dënuar me vendim penal të formës së prerë”*.

26. Trupi gjykues arrin në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b, të neni 148, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Tom Dedaj, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.01.2022.

## **ANËTARËT E TRUPI GJYKUES**

**Anëtare**  
**Firdes Shuli**

**Anëtare**  
**Suela Zhegu**

**Relatore**  
**Alma Faskaj**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*